

QENDRA E RESURSEVE
e prindërve të fëmijëve
me aftësi të kufizuara



ÇFARË DUHET TË DIMË DHE
SI TË SILLEMI
NDAJ PERSONAVE
ME PENGESA
TRUPORE

ÇFARË LLOJE TË PENGESAVE TRUPORE EKZISTOJNË?

Rreth 600 milion persona, gjegjësisht rreth 10% të popullatës botërore, janë me ndonjë pengesë trupore.

Shkaqet për pengesën trupore mund të jenë të lindura, pasojë e ndonjë sëmundjeje trashëguese ose të fituara (aksidente trafiku, luftëra, sëmundje, moshë, mungesë e ushqimit).

Personat me pengesë trupore, sipas arsyes së paraqitjes së pengesës, mund të jenë: persona me paraplegji ose kuadriplegji, persona me distrofi muskulore, paralizë cerebrale, multipleks sklerozë si dhe pasojë e ndonjë gjendje tjetër ose sëmundje.

Secili prej këtyre llojeve ka veçoritë dhe karakteristikat e veta, së paku në kuptim të asaj nëse personi mund të funksionojë ose jo pavarësisht dhe nëse ka nevojë për asistencë nga ndonjë person tjetër.



Çfarë mund të bëj...



**Mund të bisedoj, të mendoj, të mësoj,
të ndjej.**

**Mund të shoqërohem dhe të luaj me
bashkëmoshatarët e mi.**



Mund të shkoj në kopsht për fëmijë.

Mund të shkoj në shkollë.



Mund dhe dëshiroj të marr pjesë në të gjitha aktivitetet.

Kam nevojë vetëm për një hapësirë të mjaftueshme që edhe unë të mund të kyçem në mënyrë aktive.



Nëse jemi në rreth, zgjeroni rrethin që të ketë vend edhe për mua.

Mund të mbaroj shkollën fillore, shkollën e mesme dhe të përfundoj fakultetin.

Mund të marr pjesë në kremtime dhe shfaqje teatrore.



Mund të mësoj të luaj një instrument muzikor.



Mund të jem model/modele.



Mund të merrem me sport dhe të garoj.



Mund të punoj.



Mund të dashurohem dhe të formoj familje.

Mund të mësoj të drejtoj makinë.



Mund të jem i/e lumtur.



Të gjitha këto do të mund t'i bëjë me mbështetjen e FAMILJES sime më të ngushtë dhe më të gjerë, MIQTË e mi dhe KOMUNITETI që do të më sigurojë kushte të përshtatshme.

Këshilla për sjellje ndaj personave me pengesa trupore



Mos supozoni

Mos bëni supozime për aftësitë e tjerëve. Të qenit në karrocë invalide nuk do të thotë që personi është i paralizuar ose që nuk është në mundësi që vet të gjendet në hapësirë, madje edhe të bëjë disa hapa. Disa persona përdorin karrocë për shkak të problemeve për ecje në distanca të largëta, për shkak të qëndrimit të gjatë në këmbë ose problemeve me zemër. Mos supozoni – pyetni! Me kujdes parashtroni pyetjen duke filluar me “nëse nuk ju pengon që ju pyes, për çfarë përdorni karrocë?”

Kjo pyetje është e përshtatshme vetëm kur jeni njoftuar paraprakisht me personin.



Silluni me respekt

Flitni drejtpërdrejtë me personin në karrocën invalidore. Nëse personi është shoqëruar nga një person tjetër, përfshijeni edhe atë person në bisedë, por jo në vend të personit në karrocë. Asnjëherë mos drejtoni pyetje për personin me pengesa trupore, drejt ndonjë personi tjetër përveç vetë personit.





Bëhuni të sjellshëm

Çdoherë kërkoni leje nga personi që përdor karrocën para se të prekni. Prekja pa arsye dhe mbështetja në karrocën është e pasjellshme dhe pa respekt.

Shikoni karrocën si pjesë e trupit të personit që përdor. Nëse nuk do të prekni personin në shpatull, pa nevojë, mos e prekni edhe karrocën.



Bëhuni të këndshëm

Kur për herë të parë takoni person në karrocë invalidore, jepjani dorën, njëlloj sikur do të kishit bërë me çdo person tjetër. Dhënia e dorës themelon një lidhje fizike dhe zvogëlon barrierat psikologjike për lidhje emocionale. Madje edhe kur bëhet fjalë për ekstremitet të amputuar ose protezë, dhënia e dorës është në përgjithësi e pranueshme.



Komunikoni në mënyrë të qetë

Bisedoni në mënyrë të qetë, siç do të kishit biseduar me çdo person tjetër. Mos i zgjidhni fjalët për të shmangur përdorimin e fjalëve "vrapim" ose "ecje". Ajo vetëm do e bën bisedën e çuditshme, ndërsa pjesa më e madhe e personave në karroca invalidore nuk i konsiderojnë ato fjalë si fyerje.

Mos bëni shaka dhe komente në lidhje me karrocën invalidore. Nëse personi bën ndonjë shaka, nuk duhet ta injoroni dhe lirisht bashkohuni me të. Por, ju asnjëherë nuk duhet të jeni nismëtari i shakave të tilla.

Keni kuptim për nevojat e personave me pengesa trupore

Kuptoni aftësinë e veçantë të drejtimit të karrocës invalide kur e shoqëroni personin jashtë. Kërkoni rampat. Zakonisht gjenden në pjesën anësore të dyerve të restoranteve, tualeteve, dyqaneve ose afër shkallëve, ashensorëve, etj. Nëse keni korsi të gjatë për të kaluar, pyeteni personin "cila është mënyra më e lehtë për të bërë këtë?" Pastaj, me vëmendje ndiqni udhëzimet e tij/saj. Nëse organizoni ngjarje, keni kujdes mbi qasjen.



Shënoni vendet nga të cilat mund të qaset me karrocë invalide. Kontrolloni hapësirën për manovër në korridore, tualete. Nëse ngjarja është jashtë, kontrolloni nëse sipërfaqet me rërë dhe gurë të imtë mund të paraqesin vështirësi për lëvizjen e personave në karrocë invalide.



Ofroni ndihmë

Keni konsideratë kur përdorni hapësira publike. Disa vende publike, siç janë vendet e parkimit, tavolinat në restorante, vendet në bankat shkollore, janë të parashikuara vetëm për persona në karrocë invalidore. Mos i përdorni këto vende të shënuara, përveç nëse nuk shoqëroni person në karrocë invalidore. Ju keni mundësi të zgjidhni nga shumë vende tjera në parking, restorant, klasë, ndërsa personat në karrocë kanë qasje vetëm në vendet e shënuara.

Ofroni ndihmë por mos supozoni që personi në karrocë çdo herë ka nevojë për ndihmë. Çdoherë në fillim pyetni. Mos u ndjeni të ofenduar nëse ju refuzohet ndihma, me siguri bëhet fjalë për ndonjë person mjaft të pavarur. Pyetni nëse mund të ndihmoni me atë që do të mbani derën në hyrje ose të ngritni rampën e lartë.

Asnjëherë mos lëvizni vendin e ndonjë karroce invalidore pa leje. Ndoshta personi e ka vendosur në vend që më lehtë të kalojë në atë nga vendi i uljes.


Mesazhe të rëndësishme nga personat me pengesa trupore

- ✓ Mos e shiko mungesën time si problem
- ✓ Kupto që mungesa ime është veçori e imja
- ✓ Unë mund të kontribuoj për komunitetin në mënyrën time
- ✓ Më ndihmo të mësoj atë që dëshiroj
- ✓ Bëhu person që dëgjon dhe mos më moho luftën time duke u munduar të drejtosh gjithçka
- ✓ Mos përdor teori dhe strategji për mua, qëndro me mua
- ✓ Më njofto, më respekto, sepse respektimi do të thotë barazi.
- ✓ Dëgjo, mbështet dhe ndiq!



*Bashkohuni me ne që bashkërisht të
krijojmë një botë ku do të ketë vend
për secilin.*

*Planeti jonë është mjaft i madh dhe
të gjithëve mund t'ju mundësojë
pjesëmarrje, funksionim dhe barazi në
shoqëri.*



QENDRA E RESURSEVE
e prindërve të fëmijëve
me aftësi të kufizuara

QENDRA E RESURSEVE

rr. Vasko Karangeleski 33

1000 Shkup

++389 78 449 851

++389 78 449 852

www.resursencentar.mk

Hartimi i broshurës është mundësuar me mbështetjen financiare e UNICEF-it, në kuadër të projektit: "Rritja e Mundësive për Inkluzion dhe Përmirësimi i Cilësisë së Jetës së Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara me anë të Fuqizimit të Prindërve dhe Familjeve të Tyre".

unicef 

Qëndrimet e shprehura në këtë broshurë janë vetëm të autorëve dhe nuk duhet patjetër të përputhen me qëndrimet dhe politikatat e UNICEF-it.